

MËSIMI 6

1. Çfarë është fillimi?

-Fillimi është periudha para shumë kohësh kur Perëndia krijoi gjithçka.

2. Në fillim, kush e krijoi gjithçka që është në botë?

-Perëndia.

3. Çfarë kishte në botë para se Perëndia të krijonte gjithçka?

-Asgjë.

4. Nëse nuk kishte asgjë në botë, atëherë çfarë përdori Perëndia për të krijuar gjithçka?

-Asgjë.

5. Atëherë si e krijoi Perëndia botën?

-Perëndia e krijoi botën nga asgjëja.

6. Si ka mundësi që Perëndia mundi të krijonte gjithçka nga asgjëja?

-Perëndia është i gjithpushtetshëm.

-Fuqia e Perëndisë nuk mbaron kurrë.

-Fuqia e Perëndisë është e përjetshme.

7. A ka ndonjë kufi fuqia e Perëndisë?

-Jo.

8. A janë Satani, demonët e tij ose njerëzit më të fuqishëm se Perëndia?

-Jo.

9. A e mësoi dikush Perëndinë si të krijonte gjithçka?

-Jo.

10. Pse nuk e mësoi njeri Perëndinë?

-Në fillim, nuk kishte asnjë njeri që ta mësonte Perëndinë.

-Përveç kësaj, Perëndia nuk ka nevojë që ta mësojë dikush.

11. A di çdo gjë Satani, demonët e tij ose njerëzit ashtu si di Perëndia?

-Jo.

-Vetëm Perëndia di gjithçka.

-Në fillim, Perëndia krijoi qiejtë dhe tokën.

-Le të lexojmë si ishte toka para se Perëndia të krijonte gjithçka.

Le të lexojmë Zanafilla 1:1-2a

1-Në fillim, Perëndia krijoi qiejtë dhe tokën.

2-Toka ishte pa trajtë, e zbrazët dhe errësira mbulonte sipërfaqen e humnerës.

-Si ishte bota para se Perëndia ta krijonte atë?

-Në fillim, nuk kishte dritë.

-Në fillim, errësira mbulonte të gjithë tokën.

-A do të pëlqente ty nëse nuk do të ishte drita e diellit ditën?

-Jo.

-A do të pëlqente ty nëse nuk do të ishte drita e hënës natën?

-Jo.

-A nuk do të ishte e tmerrshme nëse nuk do të kishte dritë në tokë?

-Po.

-Ju nuk do të kishit mundësi të shikonit të mbjellat në fushë.

-Ju nuk do të kishit mundësi të shikonit si të ndërtonit shtëpitë tuaja.

- Ju nuk do të kishit mundësi të shikonit njëri-tjetrin.

-Në fillim, nuk kishte dritë.

-Në fillim, nuk kishte as tokë të thatë.

-Në fillim, ujërat mbulonin të gjithë tokën.

Le të lexojmë Zanafilla 1:2b

2-Errësira mbulonte sipërfaqen e humnerës, dhe Fryma e Perëndisë fluturonte mbi sipërfaqen e ujërave.

-Në fillim, nuk kishte jetë në tokë.

-Por Perëndia Frymë e Shenjtë ishte atje.

-Perëndia Frymë e Shenjtë po priste për të filluar punën e Tij për të krijuar gjithçka.

-A e mban mend që ka vetëm një Perëndi, por që janë tre persona që janë një Perëndi?

-Perëndia Atë, Perëndia Bir (Shpëtimtari) dhe Perëndia Frymë e Shenjtë së bashku krijuan gjithçka.

-Në fillim, çfarë krijoi Perëndia ditën e parë?

Le të lexojmë Zanafilla 1:3

3-Pastaj Perëndia tha, "U bëftë drita," dhe drita u bë.

-Në ditën e parë, Perëndia krijoi dritën.

-Si e krijoi Perëndia dritën?

-Perëndia e krijoi dritën vetëm duke folur.

-A mundet ndonjë tjetër përveç Perëndisë të krijojë dritën vetëm duke folur?

-Jo.

-Ja një shembull:

-Një natë, ti je jashtë në errësirë pa dritë.

-Nuk ka as dritë hënë as dritë yjesh.

-Është shumë errësirë, dhe ti nuk mund të shohësh dot asgjë.

-A mund të thuash ti thjesht: "U bëftë dritë" dhe drita do të vijë?

-Jo.

-Megjithatë, Perëndia vetëm foli, dhe u krijua drita.

-Nga e dinte Perëndia si ta krijonte dritën?

-Perëndia di gjithçka.

-Nuk ka asgjë që Perëndia të mos e dijë.

-A e kishte të vështirë Perëndia ta krijonte dritën?

-Jo.

-Pse?

-Perëndia është i gjithëfuqishëm.

-Nuk ka asgjë që Perëndia nuk mund ta bëjë.

-Çfarë mendoi Perëndia për dritën që Ai krijoi?

Le të lexojmë Zanafilla 1:4a

4-Perëndia pa që drita ishte e mirë.

-Drita që krijoi Perëndia ishte e mirë.

-Kjo ndodh sepse Perëndia është i përsosur.

-Çdo gjë që Perëndia bën është e përsosur.

-Burrat ndërtojnë shtëpi, por disa herë çatia pikon.

-Gratë bëjnë enë prej balte, por disa herë enët thyhen.

-Por Perëndia e krijoi çdo gjë të përsosur.

-Pse?

-Sepse Perëndia është i përsosur.

-Çfarë bëri Perëndia pasi krijoi dritën?

Le të lexojmë Zanafilla 1:4b-5

4-[Perëndia] e ndau dritën nga errësira.

5-Perëndia e quajti dritën "ditë" dhe errësirën Ai e quajti "natë." Kështu erdhi mbrëmja e pastaj erdhi mëngjesi – dita e parë.

-Kur Perëndia krijoi dritën, Perëndia nuk e hoqi gjithë errësirën tutje.

-Perëndia e la ca errësirë për natën.

-Si do të ishte nëse Perëndia nuk do të kishte lënë errësirë fare?

-Nuk do të kishim mundësi të flinim.

-Perëndia la ca errësirë që ne të mund të flinim.

-Gjithçka që bën Perëndia është e përsosur.

-Çfarë krijoi Perëndia ditën e dytë?

Le të lexojmë Zanafilla 1:6-8

6-Pastaj Perëndia tha: "Le të jetë një kupë qiellore mes ujërave, që t'i ndajë ujërat nga ujërat".

7- Dhe Perëndia krijoi kupën qiellore dhe ndau ujërat që ishin poshtë saj nga ujërat që ishin sipër saj. Dhe kështu u bë.

8-Dhe Perëndia e quajti kupën qiellore "qiell". Kështu erdhi mbrëmja, pastaj erdhi mëngjesi: dita e dytë.

-Në ditën e dytë, Perëndia krijoi qiellin.

-Si e krijoi Perëndia qiellin?

-Vetëm duke folur.

-A e pati të vështirë Perëndia për të krijuar qiellin?

-Jo.

-Pse?

-Perëndia është i gjithëfuqishëm.

-Nuk ka asgjë që s'mund të bëjë Perëndia.

-Si i ndau Perëndia ujërat që mbulonin tokën?

-Perëndia e vuri ca nga uji i tokës sipër qiellit.

-Pjesën tjetër të ujit Perëndia e la në tokë.

-Çfarë krijoi Perëndia ditën e tretë?

Le të lexojmë Zanafilla 1:9-10

9-Pastaj Perëndia tha: "Ujërat që janë nën qiellin të grumbullohen në një vend të vetëm dhe të shfaqet tera". Dhe kështu u bë.

10-Dhe Perëndia e quajti terën "tokë" dhe grumbullimin e ujërave "detë". Dhe Perëndia pa që kjo ishte mirë.

-Në ditën e tretë, Perëndia krijoi tokën e thatë.

-Në fillim, nuk kishte tokë të thatë.

-Në fillim, uji mbulonte të gjithë tokën.

-Në ditën e tretë, Perëndia i urdhëroi ujërat që të tërhiqeshin në mënyrë që të dilte toka e thatë.

-Nëse një njeri do të vinte tek lumi, a do të ishte ai në gjendje për ta komanduar lumin të lëvizte mbrapa që ai të mund të kalonte në anën tjetër?

-Jo.

-Pse vetëm Perëndia ka mundësinë për t'i komanduar ujërat që të tërhiqen, dhe ujërat do t'i binden Atij?

-Sepse ishte Perëndia, Ai që i krijoi ujërat.

-Çfarë tjetër krijoi Perëndia në ditën e tretë.

Le të lexojmë Zanafill 1:11-13

11-Pastaj Perëndia tha: "Të mbijë toka gjelbërimin, barërat të nxjerrin farë dhe drurët frutore të japin në tokë një frut që të përmbajë farën e tij, secili simbas llojit të tij". Dhe kështu u bë.

12-Dhe toka prodhoi gjelbërim, barëra që e bënë farën simbas llojit të tyre dhe drurë që mbanin fruta me farën e tyre brenda, secili simbas llojit të vet. Dhe Perëndia e pa se kjo ishte mirë.

13-Kështu erdhi mbrëmja, pastaj erdhi mëngjesi;

dita e tretë.

-Në ditën e tretë, Perëndia krijoi të gjitha bimët dhe pemët, gjithashtu.

-Si i krijoi Perëndia të gjitha bimët dhe pemët?

-Vetëm duke folur.

-A e pati të vështirë Perëndia të krijonte bimët dhe pemët?

-Jo.

-Pse?

-Perëndia është i gjithëpushtetshëm.

-Nuk ka asgjë që Perëndia nuk mund ta bëjë.

-Sa lloje të ndryshme bimësh dhe pemësh krijoi Perëndia?

-Më shumë sesa mund të numërohen.

-Pse i krijoi Perëndia të gjitha bimët dhe pemët?

-A kishte nevojë Perëndia për bimët dhe pemët për të jetuar?

-Jo.

-Për kë i krijoi Perëndia të gjitha bimët dhe pemët?

-Perëndia i krijoi ato për njerëzit.

-Pse i krijoi Perëndia të gjitha bimët dhe pemët?

-Sepse Perëndia i do shumë njerëzit.

-Nëse nuk do të kishte pemë, a do të mund të ndërtoje ti një shtëpi?

-Jo.

-Perëndia i krijoi pemët për ne sepse Ai na do ne.

-Nëse nuk do të kishte fruta, çfarë do të haje ti?

-Nuk do të kishte shumë gjëra.

-Perëndia i krijoi frutat për ne sepse Ai na do.

-Çfarë krijoi Perëndia ditën e katërt?

Le të lexojmë Zanafilla 1:16-19

16-Perëndia krijoi pastaj dy ndriçues të mëdhenj: ndriçuesin e madhë për qeverisjen e ditës dhe ndriçuesin e vogël për qeverisjen e natës; ai krijoi gjithashtu yjet.

17-Dhe Perëndia i vendosi në kupën qiellore për të ndriçuar tokën.

18-Për të qeverisur ditën dhe natën dhe për ta ndarë dritën nga errësira. Dhe Perëndia e pa që kjo ishte mirë.

19-Kështu erdhi mbrëmja dhe erdhi mëngjesi: dita e katërt.

-Në ditën e katërt, Perëndia krijoi diellin, hënën, dhe yjet.

-Si i krijoi Perëndia diellin, hënë dhe yjet?

-Vetëm duke folur.

-Pse dielli, hëna dhe yjet nuk bien nga qielli në tokë?

- Sepse Perëndia i vuri ata atje.
- Sepse puna e Perëndisë është e përsosur.

-Çfarë krijoi Perëndia ditën e pestë?

Le të lexojmë Zanafilla 1:20-21 & 23

20-Pastaj Perëndia tha: "Të mbushen ujërat nga një numër i madh qeniesh të gjalla dhe të fluturojnë zogjtë lart mbi tokë nëpër hapësirën e madhe të kupës qiellore".

21-Kështu Perëndia krijoi kafshët e mëdha ujore dhe të gjitha gjallesat që lëvizin dhe që mbushin ujërat, secili simbas llojit të vet, e çdo shpend fluturues simbas llojit të vet. Dhe Perëndia e pa se kjo ishte mirë.

23-Kështu erdhi mbrëmja dhe pastaj mëngjesi: dita e pestë.

-Në ditën e pestë Perëndia krijoi të gjithë peshqit dhe zogjtë.

-Si i krijoi Perëndia të gjithë peshqit dhe zogjtë?

-Vetëm duke folur.

-A ishte e vështirë për Perëndinë të krijonte peshqit dhe zogjtë?

-Jo.

-Pse?

-Sepse Perëndia është i gjithëpushtetshëm.

-Nuk ka gjë që Perëndia nuk mund ta bëjë.

-Sa lloje të ndryshme peshqish dhe zogjsh krijoi Perëndia?

-Më shumë sesa ndonjë njeri mund të numërojë.

-Pse i krijoi Perëndia të gjithë peshqit dhe zogjtë?
-A i duhen peshqit dhe zogjtë Perëndisë për të jetuar?
-Jo.

-Për kë i krijoi Perëndia të gjithë peshqit dhe zogjtë?
-Perëndia i krijoi ato për njerëzit.

-Pse i krijoi Perëndia të gjithë peshqit dhe zogjtë?
-Sepse Perëndia i do shumë njerëzit.

-Çfarë tha Perëndia për të gjithë atë që kishte krijuar?
-Perëndia tha që çdo gjë ishte e mirë.

-Pse ishte në gjendje Perëndia të krijonte çdo gjë të përsosur?
-Sepse Perëndia është i përsosur.

-E gjithë ajo që Perëndia krijoi në fillim ishte e përsosur.

-Në fillim, nuk kishte gjemba.
-Në fillim, nuk kishte barishte të këqija.
-Në fillim, të gjitha frutat rriteshin shumë të mira.

-Perëndia e krijoi çdo gjë të përsosur sepse Ai na do ne shumë.